



Republika e Kosovës

Republic of Kosovo



Komuna Hani i Elezit

Municipality of Hani i Elezit

02/ 310 2024
10.01.2024

Duke u bazuar në nenin 80 dhe 81 të Ligjit për Zyrtarët Publikë nr. 08/L-197, nenin 8 të Ligjit të Punës së Republikës së Kosovës nr.03/L-212, nenin 69 pika 1.1 të Ligjit për Shëndetësi Nr.04/L-125, nenin 15 pika 1.3 të Udhëzimit Administrativ (shëndetësi) 04/2020 Kujdesi Parësor Shëndetësorë, Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Kryetari i Komunës në Hani i Elezit Shpall këtë:

KONKURS

PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

Titulli i vendit të punës: Stomatolog në QKMF

Institucioni: Qendra Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr.Menduh Kaloshi" Hani i Elezit

Drejtoria: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Lloji i pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik

Numri i Pozitave: një (1)

Titulli i mbikëqyrësit: Drejtori i QKMF-së

Grada/Koeficienti: Koeficienti H 10-7.4

Orët e punës: 40

Kohëzgjatja e Kontratës: (pa afat)

Periudha provuese: 6 (gjashtë) muaj.

Detvrat dhe përgjegjësitë:

1. Jep shërbime stomatologjike.
2. Avancoon dhe promovon shëndetin oral.
3. Organizon dhe koordinon punën me asistenten në stomatologji,
4. Kujdeset për mjetet e punës.
5. I përmbahet etikës mjeksore.
6. Ndhmon dhe siguron mirësjellje e kujdes të veçantë në lëminë të cilën është trajnuar.
7. Mban evidencën e rregullt të dokumentacionit mjekësorë, kartelën e pacientit si dhe dokumente të tjera.
8. Jep udhëzime me gojë dhe me shkrim për trajtime të pacientit .
9. Merr pjesë në hartimin e planit dhe programit në vendin e punës ku punon.
10. Mban kujdestarinë e radhës dhe kryen punë tjera sipas kërkesës së eprorit.
11. Kujdeset për shëndetin e pacientëve, përshkruan dhe administron tretmanët, medikamentet dhe i aplikon masat tjera shëruuese.
12. Ndhmon në preventivin e sëmundjeve dhe çrregullimeve duke këshilluar pacientët në lidhje me dietën, ushtrimet , higjienën dhe shëndetin në përgjithësi.
13. Të i referon pacientët tek specialistët mjekësorë dhe të shkëmben me ta të dhënat mjekësore.
14. Të përpilon raporte me shkrim lidhur me punën dhe veprimet e tij.
15. Të kryen edhe detyra tjera që kërkohen nga mbikëqyrësi për të siguruar efikasitetin e lartë në punë.

Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për rekrutim:

1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
3. Të ketë licencën e punës.
4. Njohuri profesionale me përvojën e duhur si dhe aftësi komunikuese e organizative.
5. Të ketë gatishmëri të punoj në gjitha grupet pa dallim: moshe, gjinie, etnie, religjioni apo race.
6. Të zotëroj njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.
7. Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për t'i kryer detyrat përkatëse.
8. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për ndonjë vepër penale.
9. Të mos ketë në fuqi ndonjë masë disiplinore.

Dokumentet e nevojshme:

- Diploma Universitare-fakulteti i mjekësisë drejtimi i Stomatologjisë (e vërtetuar).
- Licenca e Punës (e vërtetuar).
- Dokumentin e identifikimit.
- Certifikatën që nuk është nën Hetime (nga Gjykata).
- Certifikatën mbi gjendjen shëndetësore (për arsye të minimizimit të shpenzimeve të kandidatëve kërkohet në fund të procedurës së rekrutimit vetëm nga kandidati më i sukseshëm)
- Certifikatën që dëshmon njohuri nga kompjuteri dhe njohuri tjera e dëshirueshme .
- Kualifikime tjera (Trajnime).

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda 30 ditëve nga data **10.01.2024 deri 08.02.2024 (16:00)**. Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit mund ti marrin në formë fizike pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në Han të Elezit kati i parë dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend, apo ti shkarkojnë në portalin shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net>

Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kriteret e konkursit nuk do të shqyrtohen ndërsa në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët që i plotësojnë kriteret e që futen në listë të ngushtë. Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet, jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këtë pozitë, duhet që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura (nostrifikuara) nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me Udhëzimin Administrativ, nr.12/2018 të datës 10.09.2018, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit. Mirëpriten aplikacionet e femrave dhe meshkujve të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Konkursi dhe rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/>, në webfaqen e komunës <https://kk.rks-gov.net/haniielezit> dhe në tabelën e shpalljes.

Kryetari i Komunës
Mehmet Ballazhi

